



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 592/3 prot.

Tiranë, më 26.02.2019

VENDIM

Nr. 18, datë 26. 02.2019

PËR  
MIRATIMIN E KANDIDATIT PËR “ADMINISTRATOR” TË FAKULTETIT TË  
SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË

Bordi i Administrimit, në bazë të nenit 52, germa “e” të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të Vendimit nr. 48, datë 01.11.2018 “Për kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së “Administratorit” të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, pasi u njoh me procesverbalin e Komisionit “Mbi procedurën e vlerësimit...” nr. 2672/15 prot., datë 29.01.2019, dhe mori në shqyrtim shkresën e Administratorit nr. 564 prot., datë 20.02.2019 “Procedura e kandidimit për administrator në FSHMT”, pas diskutimeve në mbledhjen e datës 26.02.2019 me Administratorin e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. T’i dërgojë Administratorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, kandidaturën e z. Sokol Hoxha, si kandidatura e vlerësuar me më shumë pikë nga Komisioni i Vlerësimit të Kandidatëve për “Administrator” pranë FSHMT, sipas procesverbalit të këtij komisioni nr. 2672/15 prot., datë 29.01.2019.
2. Ngarkohet, në bazë të nenit 52, germa “e” të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe Sektori i Burimeve Njerëzore për zbatimin e hapave të mëtejshëm procedural.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
Adriana BERBERI

*Adriana Berberi*

